



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.03-350
13.11.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3912/1 datë 27.10.2023 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-4077/7 datë 10.11.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 36-të mbajtur më 10.11.2023, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës - vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Ndërmarrja Publike Radiodifuzive (NPR) RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor (RTM5), për shkeljen e kryer të nenit 92 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 5 tetor 2023, nuk ka transmetuar së paku 40% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3912/1 datë 27.10.2023, i cili është pjesë përbërëse i këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. URDHËROHET NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor (RTM5) që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga Ligji i cituar, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akteve të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 92 paragrafi (1) nga LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruara gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi transmetues publik së paku 40%.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 27 tetor 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore, nga ku konstatohet se më 5 tetor 2023, shërbimi programor televiziv i NPR RADIOTELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor (RTM5) ka transmetuar 8 orë 49 minuta e 15 sekonda programi të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, që përbën 37,07% të totalit të programit të transmetuar gjatë ditës, i cili përfshihet në llogaritjen për program të krijuar burimor (23 orë 47 minuta dhe 32 sekonda). Minimumi ligjor prej 40% për

transmetim të programit burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 5 tetor që hyn në llogaritjen e programit të krijuar burimor (23:47:32), është 9 orë dhe 31 minuta. NPR REDIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë i programit (RTM5), ka transmetuar për 41 minuta e 45 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark. nr.10-3912/1 datë 27.10.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup – Televizioni i maqedonisë - Shërbimi i pestë programor (RTM5), më 31.10.2023, dërgoi Shkresë me ark.nr. 10-3912/2 datë 31.10.2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark. nr.10-3912/1 datë 27.10.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregull nga transmetuesi më 31.10.2023, për të cilën në afatin e parashikuar NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor (RTM5), ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave nga LSHMAAV, nr. ynë ark. 10-3912/3 datë 3.11.2023. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 10.11.2022, e shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim dhe konstatoi që NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor (RTM5) t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark. nr.10-3912/1 datë 27.10. 2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 36-të mbajtur më 10.11.2023, në pajtim me Konkluzionin ark.nr. 02-4077/7 datë 10.11.2023, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron NPR RADIOTELEVIZIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i pestë programor (RTM5) dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit, të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) nga LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër është marrë vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-3912 /1 datë 27.10.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.